1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

## Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:**

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*
- b) elementet fiskale;*
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

**Shtojca 3.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

**Shtojca 4.**

---

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

## Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Skicimet, parametrat teknik etj:

Agjencia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave:

#### 1 - Tavolinë pune + Komodinë – 15 copë

**Tavolina e punës**, duhet të jetë me material laminat me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Dimensioni (140 x 70 x 72 cm). Tavolina do të ketë një strukturë të përbërë nga dy panele anësorë me përmasa 72 x 70 x 2.5 cm, (Lartësi-gjerësi-trashësi) të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën ballore (materiali i njëjtë me tavolinën). Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesoren përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kabllave të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatorë plastikë kundër lagështirës.

**Komodina** përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën. Njëri prej sirtarëve me çelës. Përmasat: 40 x 60 x h-70 cm

**Garancia 2 vite.**

#### Model Orientues



#### 2 – Klasifikator metalik (raft arkivimi) me tre sirtarë – 5 copë

Klasifikatori (raft) duhet të jetë i ndërtuar nga strukture metalike e cilësisë së lartë. Të ketë një ndarje me tre sirtarë. Me rezistencë maksimale ndaj degradimit me kalimin e kohës dhe ndaj ndryshkjes falë ngjyrës së aplikuar dhe të trajtuar me anë të pjekjes. Sirtarët të jenë me çelës.

- Materiali: Metalik
- Numri i sirtarëve: 3
- Përmasat: 100-105 x 46 x 60-65 cm

#### Model orientues



### 3 – Klasifikator metalik (raft arkivimi) me dy sirtarë - 4 copë

Klasifikatori (raft) duhet të jetë i ndërtuar nga strukturë metalike e cilësisë së lartë. Të ketë një ndarje me dy sirtarë. Me rezistencë maksimale ndaj degradimit me kalimin e kohës dhe ndaj ndryshkjes falë ngjyrës së aplikuar dhe të trajtuar me anë të pjekjes. Sirtarët të jenë me çelës.

- Trashësia: 0.7 mm
- Thellësia: 620 mm
- Materiali: Metal
- Gjerësia: 460 mm
- Lartësia: 700 mm


#### Model orientues



### 4 – Karrige drejtuesi ergonomike – 1 copë

Baza e karriges duhet të ketë një diametër prej 660 mm në formë 5 yje. Në mekanizmin e karriges duhet të jetë vendosur aktivizimi i ngritësit të gazit rregullues sipas lartësisë. Pistoni i gazit për rregullimin e lartësisë së sediljes aktivizohet nga një levë e vendosur nën dhe anash sediljes.


- Mbështetësja e karriges duhet të jetë me mekanizëm Synchro, që lejon lëvizjen dinamike të njëkohshme të ndenjësës dhe mbështetëses, që mund të rregullohet sipas peshës së përdoruesit duke u pozicionuar në të paktën pesë nivele. Korniza mbështetëses të jetë e përbërë nga profile poliamide termoplastik për shpërndarjen e presionit, që të sigurojë rehati dhe ergonomi maksimale. Mbulesa e pasme e mbështetëses të jetë e përbërë nga një kornizë anatomike nga profilet e poliamidit, mbi të cilat të vendoset një mbështetëse me përbërje lëkurë ekologjike dhe e certifikuar kundër djegies.
- Ndenjësja e karriges të jetë e përbërë nga poliamid termoplastik dhe jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuretani, mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar dhe mekanizëm lëvizje për rregullim pozicioni (të rrëshqasë horizontalisht në thellësi) në të paktën tre nivele nëpërmjet një leve të vendosur nën/anash sediljes dhe e lehtë në përdorim.
- Krahët e karrigeve të jenë të përbërë nga poliamidi termoplastik dhe i rregullueshëm në lartësi. Pjesa e sipërme e krahëve të mund të rrotullohet katër dimensionale (majtas-djathtas, lart-poshtë si dhe të hapen e të mbyllen), të ketë përbërje poliuretani hedhur me fortësi të mesme për rehati maksimale, ergonomi si edhe mundësi të zhvendoset para-mbrapa në të paktën në dy pozicione.
- Koka e karriges të ketë mekanizëm të lëvizshëm dhe të lëvizë lart-poshtë, në të paktën dy nivele, jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuterani, si dhe mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar.
- Karrigia të ketë kokën dhe ndenjësen me tapiceri të të njëjtit material me lëkurë artificiale/prodhuar.
- Dimensionet të jenë të përafërta si të skicës ilustruese, si dhe mekanizmat e karriges ergonomike.
- Pesha 30-33 kg.



## 5 – Karrige ergonomike (me mbështetëse koke) – 59 copë

- Karriget të jenë të certifikuara sipas standarteve ergonomike europiane dhe ngjyrë të zezë.
- Baza e karriges të jetë alumin në formën e ylli me 5 këmbëza në përmasat të përafërta 650-670 mm.
- Karriget të jenë rrotulluese dhe me rrota dyfishë, të përbëra me material termoplastik, i përforcuar (poliamide).
- Karrigia të jetë e pajisur me piston gazi për rregullimin e lartësisë.
- Mekanizmi mbështetës i ndenjësës duhet të jetë me mekanizëm "Synchro" dhe i bërë nga alumini dhe çeliku. Të lejojë shtrirjen e sinkronizuar të sediljes dhe mundësi stabilizimi në 4-5 pozicione. Ndenjësja duhet të ketë mekanizëm me sistem "anti-panik" dhe një sistem rregullimi për shtrirje të balancuar sipas peshës së përdoruesit.
- Pllaka e ndenjësës të jetë prej poliamidi të derdhur me injeksion (PA6). Në pllakën e ndenjësës shtrihet jastëk i bërë nga shkumë poliuretani i zgjeruar me trashësi jo më pak se 50 mm, i cili të jetë i veshur me susta dhe me pëlhurën e zgjedhur. Dimensionet e ndenjësës: gjerësia jo më pak se 480 mm, thellësia jo më pak se 480 mm.
- Pjesa e mbështetëses të ketë një kornizë anatomike të bërë nga poliamidi termoplastik, mbi të cilin rrjeta e pasme të vendoset në mënyrë të tillë që presioni të shpërndalet në mënyrë të barabartë. Të jetë e lidhur me mekanizmin mbështetës të sediljes përmes një tehu me kënd çeliku. Pjesa e pasme duhet të ketë një mekanizëm të pavarur të rregullimit të lartësisë në jo më pak se 5 pozicione të ndryshme. Përveç kësaj, pjesa e pasme duhet të sigurojë një mbështetje të mesit, të integruar, me rregullim të lartësisë për rehati më të madhe. Mbështetësja të jetë në dimensionet të përafërta 570X475mm.
- Karrigia duhet të ketë mbështetëse koke të rregullueshme në lartësi e bërë prej material termoplastik, shkumë poliuretani dhe tapiceri e së njëjtit material si ndenjësja.
- Krahët e karriges të jenë prej poliamidi termoplastik dhe të mund të rregullohen në lartësi, distanca nga sedilja 140-240 mm. Sipërfaqja e kontaktit të krahët të jetë e bërë nga poliuretani i derdhur me fortësi mesatare për rehati dhe ergonomi më të madhe, të lëvizshme majtas-djathtas, lart-poshtë dhe para-mbrapa.
- Materiali i tapicerisë të jetë ekologjik sipas standarteve të certifikimit.
- Pësia e karriges 16-18 kg.

Model orientues



**Të tjera:**


Ngjyra e tavolinës do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës, sipas porosisë se Autoritetit Kontraktor.


Ngjyra e karriges, e cila do të jetë kryesisht e zezë ose do të kërkohet në momentin e lidhjes së kontratës, sipas porosisë se Autoritetit Kontraktor.

• **Agjencia e Inovacionit dhe Ekselences:**

<b>Karrige të thjeshta zyre</b>	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skeleton metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike.		Copë
	Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018		


<b>Varëse rrobash</b>	<p>Koka duhet të jetë e pajisur me 5 ganxha mbajtëse dhe 5 varëse të harkuara.</p>	<p>Diametri rrethor bazamenti mbajtës D: 48-50 cm; Boshti metalik L: 175-180 cm; Diametri i boshtit metalik: minimumi 5 cm; Mbajtëse për çadrat diametri: 27 cm me 4 vende</p>	<p>Copë</p>	
	<b>Raft metalik për arkivë</b>	<p>Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjes në vend.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	<p>100 x 42 x 250 cm</p>	<p>Copë</p>
<b>Raft për dosje, material MDF</b>	<p>Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet të kihen kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore në mënyrë që të ketë një distancë të vogël nga dollapi me dyshtemenë. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fibër 4 mm. Kanatat prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	<p>90 x 45 x 200 cm</p>	<p>Copë</p>	
				

<p><b>Dollap</b></p>	<p>Me bango (imitim mermeri të bardhë) 4 cm, materiali MDF me lyerje 1.8-2 cm, me tre ndarje ku dy janë me kanata dhe një e hapur me ndarje në mes. Struktura e brendshme pllake zdrukthi e melaminuar 1.8cm. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Shpina e mobiljes te jete fiber 4mm trashesi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p> 	<p>120 x 50 x 85 cm</p>	<p>Copë</p>
----------------------	--	-------------------------	-------------

<p><b>Dollap</b></p>	<p>Me bango (imitim mermeri të bardhë) 4 cm, materiali MDF me lyerje 1.8-2 cm, me tre ndarje ku dy janë me kanata dhe një e hapur me ndarje në mes. Struktura e brendshme pllake zdrukthi e melaminuar 1.8cm. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Shpina e mobiljes te jete fiber 4mm trashesi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p> 	<p>120 x 50 x 85 cm</p>	<p>Copë</p>
----------------------	--	-------------------------	-------------

<p><b>Kasaforta sekrete</b></p>	<p>Kasaforta duhet të ketë strukturë llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e pajisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete.</p> <p>Lyerja me mënyrë elektrostatische. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm.</p>	<p>50 x 50 x 110 cm</p>	<p>Copë</p>
---------------------------------	---	-------------------------	-------------


<b>Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)</b>	<p>Thellësia e brendshme 2.5cm e këtij dollapi 180 x 120cm do të thotë se është e lehtë të montosh njoftime. Veshjet elegante prej alumini sigurojnë një mënyrë tërheqëse dhe të qëndrueshme për të kornizuar informacionin dhe njoftimet tuaja të rëndësishme. Dera me mbyllje me celës përmban panel akrilik transparent rezistent dhe siguri. Rubber-Tak është një sipërfaqe me strukturë unike e prodhuar nga gome e ricikluar për të siguruar qëndrueshmëri të pakrahasueshme. Vrimat e kunjve praktikisht zhduken në sipërfaqen e vetë-shërimit, e cila është gjithashtu rezistente ndaj njollave. Goma është rezistente ndaj lagështirës, rezistente ndaj kimikateve dhe nuk do të mbështesë rritjen e mykut ose baktereve. Paneli akrilik i qartë rezistent ndaj copëtimit Zgjidhni midis mbështjellësve prej gome-tak, tape natyrale ose vinili.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015</p>	Min 180x7.5 D x120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm	Copë
---	---	--	------

<b>Ekspozitorë</b>	<p>Dy panele druri të lehtë (paulania, ose zdrukthi), orientimi horizontal, me përmasa secila 90 x 220 cm, të kapura në brinjën e ngushtë me 2-3 mentesha metalike estetike, dhe të montuara me hapje/kënd 15 gradë me njëra-tjetrën, dhe të lidhura në bazament për qëndrueshmëri. Secili panel ka të montuar 4 xhepa horizontale (90 cm të gjatë dhe 12 cm të gjerë) të vendosur me 50 cm largësi njëri nga tjetri gjatë gjithë lartësisë së panelit.</p> 	90 x 220 cm	Copë
--------------------	--	-------------	------

<b>Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona</b>	<p>Syprina MDF, jo e shkëlqyeshme pa venatura druri me trashësi 4 cm, me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë inox. Bordet anësore të planit të punës të jenë të harkuara. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë, që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004</p>	240 cm x 120 cm x 75 cm	Copë
--	--	-------------------------	------

<b>Emërtimi I Pajisjes</b>	<b>Njësia</b>	<b>Specifikime Teknike</b>
----------------------------	---------------	----------------------------

Tavolinë Zyre / Tavolinë Pune	Cope	<p>Përmasat e tavolinës të jenë me gjatësi 1.50 m dhe gjerësi 0.68 m. Syprina është prej melamine me trashësi 2.5 cm, me veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë të ndërtuara nga materiali metalik ose plastike të qëndrueshme të mbështetura mbi rrota. Bashkimi i planit të punës (syprines) është realizuar në mënyrë që t'i japë tavolinës një pamje solide në formë drejtëkëndore. Aksesoret e përdorur për montimin e elementeve të tavolinës janë cilësore. Këmbët janë të pajisura me mekanizëm nivelues dhe me rrota, në mënyrë që të jetë e lehtë lëvizja e tavolinës. Tavolina është në formë drejtëkëndore. Kjo lejon që disa tavolina të lidhen së bashku, duke formuar një strukturë të hapur, e cila mund të përshtatet në forma të ndryshme, varësisht nga nevojat e hapësirës së punës. Cdo seksion ka një hapësirë pune të mjaftueshme për një punonjës, duke përfshirë hapësirë për një laptop, dokumente dhe disa aksesore të vegjël zyre. Tavolina duhet të ketë hapësirë për menaxhimin e kablllove, duke lejuar kalimin e tyre nëpër kanale të dedikuara ose përmes kornizës së tavolinës. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 5127-1:2011. SSH EN 527-2:2016 + A1: 2019 (EN, e njëjvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004</p>
----------------------------------	------	---





- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Shkolla	Specifikimet e tavolinave (Tavolinë klase)	Specifikimet e karrigeve (Karrige klase)
<b>Shkolla Teknike Ekonomike</b>  <b>Shkolla Profesional Petro Sota</b>  <b>Shkolla Profesionale Teknike Korce</b>  <b>Shkolla e Mesme Pavaresia Vlore</b>  <b>Shkolla e Mesme Profesionale Thoma Papapano</b>	<p>Skeleti me strukturë metalike. Këmbët janë prej çeliku dhe janë të pajisura me këmbëza niveluese. Ato lidhen me njëra tjetrën me traversa të po të njëjtit material. Në pjesët ballore tavolina mund të mbulohet me panele melamine me gjerësi jo më të vogël se 16 cm dhe trashësi 1.6 cm. Të gjitha pjesët metalike janë të lyera me bojë elektrostатike me qëndrueshmëri të lartë ndaj ndryshkjes dhe gërvishtjeve. Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të syprinës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015 180 x 60 x 75 cm</p>	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku diametër 18 të harkuar me lyerje elektrostатike.</p> <p>Shpinorja dhe ndenjësja janë plastike prej polietileni ose MDF e kombinuar me kompensate. Montohen në skeleton metalik me vida.</p> <p>Dimensionet e karrikes janë: ndenjësja 39-40 cm, shpinorja 77 cm, gjerësia 39-40 cm dhe gjatësia 60 cm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p> <p>Ndenjësja: 39-40 cm, Shpinorja: 77 cm, Gjerësia: 39-40 cm, Gjatësia: 60 cm</p>

<p><b>Shkolla Profesionale Stiliano Bandilli</b></p> <p><b>Shkolla Beqir Cela, Durrës</b></p> <p><b>Shkolla Profesionale Bujqesore Kamez</b></p>		
<p><b>Shkolla Hoteleri Turizëm</b></p>		<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku diametër 18 të harkuar me lyerje elektrostатike.</p> <p>Shpinorja dhe ndenjësja janë plastike prej polietileni ose MDF e kombinuar me kompensate. Montohen në skeleton metalik me vida.</p> <p>Dimensionet e karrikes janë: ndenjësja 39-40 cm, shpinorja 77 cm, gjerësia 39-40 cm dhe gjatësia 60 cm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p> <p>Ndenjësja: 39-40 cm, Shpinorja: 77 cm, Gjerësia: 39-40 cm, Gjatësia: 60 cm</p>

<p><b>Shkolla Hoteleri Turizëm</b></p>	<p>Tavolinë modulare me syprine 76 cm x 59cm x 31 cm me profil metalik dhe trashesia 18mm, mbajetese e syprines 40 mm x 20mm, tub metalik D=40mm, ngjyra metalike, kundër gervishtjes gri e erret RAL 7043, lartesia 73 cmm,</p>
<p><b>Shkolla Profesionale Bujqesore Kamez</b></p>	<p><b>Specifikimet</b></p>


<p>Karrige statike me krahë mbështetës Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 60 x 40 x 80 cm</p>	<p>Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës në formë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë në formë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbresë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshur me lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 60 x 40 x 80 cm</p>
<p>Dollap metalik me kanata rrëshqitëse Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 120 x 45 x 200 cm</p>	<p>Dollap metalik me kanata rrëshqitëse duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dollapi është me kanata rrëshqitëse. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004 120 x 45 x 200 cm</p>
<p>Raft metalik për dosje (arshivë) Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 40 x 200 cm</p>	<p>Raftet kërkohen të jenë prej materiali metalik, me strukturë të qëndrueshme për mbajtje sasiore dokumentesh. Të jetë i ndarë me 4 sergjenë. Krahët mbajtës të jenë me vrima për vendosje raftesh horizontalë në nivele të ndryshme dhe me mbështetëse gome në pjesën fundore. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004 90 x 40 x 200 cm</p>

<p>Tavolinë për bibliotekë Përmasat: gjatësia 120 cm, gjerësia 60 cm, lartësia 74 cm</p>	<p>Syprina e tavolinës duhet të jetë prej material melamine 1.8 cm e borduar me PVC. Montimi I këmbëve me syprinën realizohet nëpërmjet një elementi lidhës për të siguruar qendrueshmërinë e tavolinës me përmasa 112 x 35 cm, me melaminë 18 mm e borduar me PVC 0.8 mm. Këmbët e tavolinës duhet të jenë prej materiali melaminë 1.8 cm me borduara PVC. Këmbët të jenë të vendosura mbi tapa palstike të cilat lejojnë regjistrimin e lartësisë. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004 Gjatësia 120 cm, gjerësia 60 cm, lartësia 74 cm</p>
<p>Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik</p>	<p>Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali metalik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë- mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë metalik dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018</p>



<p>Tavolinë nxënësi dyvendëshe për kompjuter - Arsimi i mesëm Përmasat e tavolinës për desktop: Syprina 1400 x 700 x 750 mm; Skeleti 1350 x 650 x 725 mm</p>	<p>Përmasat e tavolinës për desktop: Syprina 1400 x 700 x 750 mm; Skeleti 1350 x 650 x 725 mm; Dy çengela që ndodhen nga brenda për të varur çantat e nxënësve; Syprina e punës: Melaminë 18 mm e boeduar me PVC 0.8 mm që del mbi skelet; Skeleti është I ndërtuar me profil metalik tubolar me seksion katror 30 x 30 mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm, këmbët metalike janë të pajisur me vida rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosnivelet e dyshemesë. Nën syprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësisë qendrore e bërë me material melaminë 18 mm me përmasa: 500 x 250 x 600 mm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015</p> <p>Përmasat e tavolinës për desktop: Syprina 1400 x 700 x 750 mm; Skeleti 1350 x 650 x 725 mm</p>
<p>Karrige klase Ndenjësja: 39 x 40 cm</p>	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku diametër 18 të harkuar me lyerje elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja janë plastike prej polietileni ose MDF e kombinuar me kompensate. Montohen në skelet metalik me vida. Dimensionet e karrikes janë: ndenjësja 39-40 cm, shpinorja 77 cm, gjerësia 39-40 cm dhe gjatësia 60 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar) Ndenjësja: 39-40 cm, Shpinorja: 77 cm, Gjerësia: 39-40 cm, Gjatësia: 60 cm.</p>
<p>Stol rrotullues me rregullim lartësie</p>	<p>Ndenjëse e veshur me tapiceri speciale me mbulesë antistatike, e zezë, rregullimi i lartësisë jo me pak se 560 në 790 mm me anë të sustës së gazit, me komandimin e unazës së këmbës. Me rrota plastike dyshe antistatike me diam. Jo me pak se 50 mm dhe parakolp të zi rrethor.</p>

Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë- mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018

Shkolla	Specifikimet e tavolinave
<b>Shkolla Hoteleri Turizëm</b>	Tavolinë modulare me syprine 76 cm x 59cm x 31 cm me profil metalik dhe trashesia 18mm, mbajetese e syprines 40 mm x 20mm, tub metalik D=40mm, ngjyra metalike, kunder gervishtjes gri e erret RAL 7043, lartesia 73 cmm,



Suprine MDF 18mm Anti-gervishtje  
Ngjyre e bardhe  
Pjesa anesore e ljer  
Ngjyra Ral 7044



## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

#### Tabelë Përmbledhëse

Nr	Emertimi	Njësia	Sasia
1	Tavolina pune + komodinë	Copë	15
2	Klasifikator metalik me tre sirtarë	Copë	5
3	Klasifikator metalik me dy sirtarë	Copë	4
4	Karrige drejtuesi (ergonomike)	Copë	1
5	Karrige zyre ergonomike	Copë	59
6	Karrige të thjeshta zyre /69	Copë	62
7	Varëse rrobash/144	Copë	15
8	Raft metalik për arkivë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 42 x250 cm/21	Copë	10
9	Raft për dosje, material MDF Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 200cm	Copë	15
10	Dollap Permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 120 x 50 x 85 cm/17	Copë	10
11	Komodine zyre permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 60 x 65 cm/40	Copë	10
12	Kasaforta sekrete Permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm/50	Copë	3
13	Tabele druri për të varur shenimet (e mbyllur) Permasat: Min180 x 7.5 D x 120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm/141	Copë	5
14	Ekspozitore/156	Copë	5
15	Tavoine mbledhje rang drejtuesi, 6 persona Permasat e tavolines te jene jo me pak se 240 cm x 120 cm x 75 cm/93	Copë	2
16	Tavoline zyre/ tavoline pune	Copë	20
17	Karrige klase	Copë	1,200
18	Tavolinë klase	Copë	565
19	Karrige studenti me tavolinë të bashkëngjitur me mbështetëse krahu	Copë	140
20	Kabinet modular	Copë	26
21	Raft modular	Copë	20
22	Tavolinë mësuesi për klasë, zyrë	Copë	18

23	Karrige rrotulluese, ndenjese kompesatë ahu	Copë	18
24	Tavolinë për dy nxënës	Copë	176
25	Karrige studentore	Copë	357
26	Karrige e kthyeshme e studentit	Copë	15
27	Karrige e kthyeshme e mësuesit	Copë	4
28	Tavoline modulare me syprine 76cm x 59cm x 31cm	Copë	50

**Tabela përmbledhëse e mësipërme do të shpërndahe për AK përfituese si më poshtë me sasi të dhe afatet përkatëse:**

• **Agjencia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave:**

Nr	Emertimi	Njësia	Sasia
1	Tavolina pune + komodinë	copë	15
2	Klasifikator metalik me tre sirtarë	copë	5
3	Klasifikator metalik me dy sirtarë	copë	4
4	Karrige drejtuesi (ergonomike)	copë	1
5	Karrige zyre ergonomike	copë	59

**Afatet e lëvrimit /dorëzimit të mallit do të jetë 30 (tridhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.**

• **Agjencia e Inovacionit dhe Ekselences:**

Nr	Emërtimi i pajisjes	Njësia	Sasia
1	Karrige të thjeshta zyre /69	Copë	62
2	Varëse rrobash/144	Copë	15
3	Raft metalik për arkivë Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 100 x 42 x250 cm/21	Copë	10
4	Raft për dosje, material MDF Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 200cm	Copë	15
5	Dollap Permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 120 x 50 x 85 cm/17	Copë	10
6	Komodine zyre permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 60 x 65 cm/40	Copë	10
7	Kasaforta sekrete Permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm/50	Copë	3
8	Tabele druri për të varur shenimet (e mbyllur) Permasat: Min180 x 7.5 D x 120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm/141	Copë	5

9	Ekspozitore/156	Copë	5
10	Tavoine mbledhje rang drejtuesi, 6 persona Permasat e tavolines te jene jo me pak se 240 cm x 120 cm x 75 cm/93	Copë	2
11	Tavoline zyre/ tavoline pune	Copë	20

Afatet e lëvrimit /dorëzimit të mallit do të jetë 40 (dyzet) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

• **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**

Shkollat	Tavolina/ sasia	karrige/ sasia
Shkolla Teknike Ekonomike	100	200
Shkolla Profesionale Bujqesore Kamez	120	240
Shkolla Hoteleri Turizëm		50
Shkolla Beqir Cela, Durrës	50	100
Shkolla e mesme Profesionale Petro Sota	50	120
Shkolla Profesionale Teknike Korçë	75	150
Shkolla e mesme profesionale Pavarësia	70	140
Shkolla e mesme profesionale Thoma Papapano	50	100
Shkolla e mesme Profesionale Stiliano Bandilli	50	100

	Shkolla Profesionale Bujqesore Kamez	Sasia
1	Karrige studenti me tavolinë të bashkëngjitur me mbështetëse krahu	140
2	Kabinet modular	26
3	Raft modular	20
4	Tavolinë mësuesi për klasë, zyrë	18
5	Karrige rrotulluese, ndenjës kompesatë ahu	18
6	Tavolinë për dy nxënës	176
7	Karrige studentore	357
8	Karrige e kthyeshme e studentit	15
9	Karrige e kthyeshme e mësuesit	4

Shkolla	Specifikimet e tavolinave	Sasitë
Shkolla Hoteleri Turizëm	Tavolinë modulare me syprine 76 cm x 59cm x 31 cm me profil metalik dhe trashesia 18mm, mbajetese e syprines 40 mm x 20mm, tub metalik D=40mm, ngjyra metalike, kunder gervishtjes gri e erret RAL 7043, lartesia 73 cmm,	50 copë

Afatet e lëvrimit /dorëzimit të mallit do të jetë 30 (tridhjetë) ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

## Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

##### OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- 
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
  - Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas shtojcës 8 të DST

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. (*Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivit*).

**2.2.2** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

#### 2.3 Kapaciteti teknik:

**1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
- 1) ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme);
  - 2) ISO 14001:2015 ose ekuivalente përfshirë Leje Mjedisore, “Per Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” (e vlefshme);
  - 3) ISO 45001:2018 ose ekuivalente, “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme);
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën:
- 1 (një) inxhinier druri vërtetuar me:
    - a. kontratën individuale të punës;
    - b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.
  - 1 (një) arkitekt vërtetuar me:
    - a. kontratën individuale të punës;
    - b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.
  - 1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:
    - a. kontratën individuale të punës;
    - b. certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
  - 1 (një) Bojaxhi për prodhime druri vërtetuar me:
    - a) kontratën individuale të punës;
    - b) certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
  - 1 (një) shofer vërtetuar me:
    - a. kontratën individuale të punës ose kontratë bashkëpunimi të vlefshme;
    - b. leje drejtimi
  - 2 (dy) punonjës për montimim, asamblimin apo transportin e mallrave vërtetuar me:
    - a. kontratën individuale të punës;
5. Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në e-sig-ët e muajit të fundit.
6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Kamionçine me kapacitet mbajtës min 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

- 
- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerave.

*Për kërkesat 3-7 do të plotësohet formulari i vetedeklarimit dhe këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

7. Operatori ekonomik duhet të ketë një ambient ku ushtron veprimtarinë sipas objektit të prokurimit, prodhim ose shitje/ tregëtim/ mobilje/ pasije zyre, për të cilën duhet të paraqesë:
- akt pronësie, kontrate qiraje apo përdorimi (i regjistruar në QKB si ambient ku ushtron aktivitetin).
8. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se artikujt **“karrige” janë sipas standardeve CE.**
